



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KURBIN
KRYETARI**

Nr. _____ prot.

Laç, më _____.____.2023

Shtojca 12

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)

Data 17.11.2023

Drejtuar: Operatorit ekonomik “**ERAL CONSTRUCTION COMPANY**” SHPK, **Adresa:** Gjirokaster, Tepelene, Rruga Tepelene Progonat, Vendndodhja Skaranë, ngastra nr.80d, Kod kadastral Gj 3400080d rl, zk 1149.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” Punë (Prokurim me mjete elektronike).

Numri i procedurës / referenca: **REF-78188-08-23-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin”.

Fondi limit: **7,639,413** (shtatë milion e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e trembëdhjetë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 35 ditë / (5 jave).

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.73, datë 28.08.2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK, me numër NIPTI M03116403L.

Vlera e ofertuar: 6,445,815 (gjashtë milion e katërqind e dyzet e pesë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “**MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE**” SHPK, me numër NIPTI **K81314023A**.
Vlera e ofertuar: 6,846,080 (gjashtë milion e tetëqind e dyzet e gjashtë mijë e tetëdhjetë) lekë **pa TVSH**.
3. Operatori ekonomik “**C O L O M B O**” SHPK, me numër NIPTI **J82916489E**.
Vlera e ofertuar: 7,403,697 (shtatë milion e katërqind e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë **pa TVSH**.
4. Operatori ekonomik “**ERAL CONSTRUCTION COMPANY**” SHPK, me numër NIPTI **K82230002K**.
Vlera e ofertuar: 7,493,518 (shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) lekë **pa TVSH**.
5. Operatori ekonomik “**KLAJGER KONSTRUKSION**” SHPK, me numër NIPTI **K51423028P**.
Vlera e ofertuar: 7,617,628 (shtatë milion e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e tetë) lekë **pa TVSH**.
6. Operatori ekonomik “**TEA-D**” SHPK, me numër NIPTI **K32522629L**.
Vlera e ofertuar: 0 (zero) lekë **pa TVSH**.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- I. Operatori ekonomik “**TEA-D**” SHPK, me numër NIPTI **K32522629L**.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....”,** oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë vlerësimit të dokumentacionit, konstatoi probleme në ofertën e dorëzuar elektronikisht në SPE, nga operatori ekonomik “**TEA-D**” SHPK.

Sqarojmë se nuk hapet skedari tek “formulari i ofertës”, i etiketuar nga OE (*shtojcat.pdf (0), krijuar me 2.9.2023 ora 12:55*). Pra jemi para faktit që KVO nuk e shikon vlerën e ofertuesit

si dhe nuk shikojmë dot preventivin e ofertuesit, pasi folderi i ngarkuar në SPE nga OE nuk hapet.

Ndodhur para këtij fakti KVO, Bashkia Kurbin i dërgoi APP-së shkresën Nr.3859/8 Prot, datë 06.09.2023 “Kërkojmë identifikimin dhe zgjidhjen e problematikës, lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin”.

APP me shkresën Nr.6940/1 Prot, datë 18.10.2023, kthej përgjigje duke na informuar nder të tjera se:APP bën të mundur vetëm procesin e dekriptimit për ofertën ekonomike në rastin kur është e enkriptuar.

Ndërkohë, në lidhje me dokumentin me emërtim “Shtojcat.pdf” të ngarkuar nga operatori ekonomik pjesëmarrës “TEA-D” sh.p.k në procedurën e prokurimit me objekt: “Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin”, me numër reference REF-78188-08-23-2023, **ju sqarojmë se emërtimi i dokumentit të sipërcituar nuk rezulton të ketë prapashtesën e dokumentit të enkriptuar.**

Gjithsesi, APP menjëherë e raportoi çështjen tuaj drejt përfaqësuesve të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të atashuar pranë APP, për të kryer verifikimet e nevojshme.

Nga verifikimet e kryera rezultoi se: “Nuk shiheshin problematika në sistem lidhur me kete rast te raportuar. Nisur nga fakti që operatori ekonomik ka arritur të ngarkojë dokumenta të tjera në sistem dhe gjatë periudhës së ofertimit nuk është shfaqur problematike edhe per operatorët e tjere ekonomike qe kane ofetuar, **problematika mund të ketë ardhur nga skedari që është ngarkuar (konvertim nga word në pdf, etj).**

Sa më sipër, ky dokument nuk mund të dekriptohet nga APP. Sqarojmë se ngarkimi i dokumenteve në sistem është përgjegjësi e operatorit ekonomik, si dhe duhet të kryhet sipas udhëzimeve që APP ka publikuar lidhur me ngarkimin e dokumenteve dhe uajtjen e tyre në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Për sa më sipër, duke qenë se nuk kemi preventivin dhe vlerën e ofertuesit, KVO vendos s’kualifikimin e operatorit ekonomik “TEA-D” SHPK.

II. Operatori ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK, me numër NIPTI M03116403L.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....”,** oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

I. OE nuk plotëson pikën 2.4.3 të DST, si më poshtë:

2.4.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzojë analizë teknike të çmimeve për të gjithë zerat e preventivit të ofertës. Mos paraqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

KVO konstatoi se: OE “AIDA CONSTRUCTION” SHPK, nuk plotëson kriterin e mësipërm, pasi nuk ka paraqitur analiza teknike të çmimeve për të gjithë zerat e preventivit të ofertës (sipas VKM Nr. 629, datë 15.7.2015), si dhe ka mospërputhje, çmimi i përcaktuar në analizë me çmimin e vendosur në preventiv.

Sqarojmë se, KVO pasi verifikoi Analizat Teknike që OE ka paraqitur në SPE si dhe Preventivin, konstatoi se ka mangësi për sa më poshtë vijon:

1. OE nuk ka paraqitur fare analizë teknike çmimi për zërat e preventivit si më poshtë:
 - Ndricules tavanor fluoreshent 1x40w (zë i cili është parashikuar në objektet, III, IX, XIII, XVI).
2. Për zërin: “F.V WC alla frenga importi” ka çmim të ndryshëm preventivi me analizën teknike, ku sqarojmë se ky zë në preventiv ka çmimin 6,800 ndërsa në analizë 8600 (ky zë është në shtatë objekte, konkretisht tek II, VII, VIII, IX, X, XII, XV).
3. I njëjti zë në preventiv ka çmim ndryshe në objektin I & II, konkretisht Zëri: “Boje vaji mbi sipërfaqe te patinuar”, zë i cili në një objekt ka çmim 85, ndërsa tek objekti tjetër 100, ndërsa në analizë ka çmim 85.

III. Operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, me numër NIPTI **K81314023A**.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....”**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

KVO pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, konstatoi se operatori ekonomik nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST, si më poshtë:

- KVO konstatoi se operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, nuk plotëson pikën 2.3.8 të kriterëve të veçanta të DST-së, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kriterëve të përcaktuara në DST për mjetet (Automjet transporti 3-5 ton 2 copë & mjetet Kamioçina 2 copë).

Së pari: Sqarojmë se OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka deklaruar se disponom me qira (Automjet transporti 3-5 ton, mjetet me targa AB483BD & AB926 JU).

Por KVO verifikoi dokumentacionin që OE ka paraqitur për këto mjete (*dokumentacion i cili është i njësuar me origjinalin me Nr.5413 Rep, date 20.10.2023*) dhe konstatoi se për dy automjetet e transportit me targa AB483BD & AB926JU, nuk ka paraqitur fare Taksat Vjetore, kriter ky i përcaktuar nga AK në DST.

Së dyti: Gjithashtu sqarojmë se OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka deklaruar se disponom me qira (Kamioçinat me targa TR5568R, AA782CG, AA176YD, AB632JD).

Por KVO verifikoi dokumentacionin që OE ka paraqitur për këto mjete (*dokumentacion i cili është i njësuar me origjinalin me Nr.5413 Rep, date 20.10.2023 si dhe me Nr.5365 Rep, date 20.10.2023*) dhe konstatoi se dy mjetet me targë AA782CG & AB632JD i plotësojnë kriteret e përcaktuara në DST, pasi për këto dy mjete ka paraqitur dokumentacion e plotë, ndërsa për Kamioçinat me targë TR5568R & AA176YD nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kriterëve të përcaktuara nga AK në DST.

Sqarojmë se për Kamioçinën me targë TR5568R, përveç kontratës së qirasë Nr.46 Prot, date 01.09.2023, nuk ka paraqitur fare dokumentacion tjetër, ndërsa për kamioçinën me targë AA176YD, nuk ka paraqitur fare Taksat Vjetore, kriter ky i përcaktuar nga AK në DST.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe të nenit 82, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, **S’Kualifikohet.**

IV. Operatori ekonomik “C O L O M B O” SHPK, me numër NIPTI J82916489E.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **"Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....."**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

- KVO pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “C O L O M B O” SHPK, **konstatoi se:**

Operatori ekonomik “C O L O M B O” SHPK, nuk plotëson pikën 2.3.4 si dhe pikën 2.3.7 të kriterëve të veçanta të DST-së, pasi nuk përmbush numrin e punojnësve me kohë të plotë (22 ditë), sipas kriterëve të përcaktuara në DST.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në DST që: *operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**,..... si dhe duhet të disponojë **fuqi punëtore minimalisht 30 (tridhjetë) persona**,..... për periudhën **Maj - Qershor – Korrik 2023**.....etj.*

Sqarojmë se pas verifikimit të dokumentacionin, referuar listëpagesave, KVO konstatoi se:

- Në muajn Maj 2023 ka total 80 punonjës, nga të cilët 18 punonjës i ka me me kohë të plotë (22 ditë), 1 punonjës (me 6 ditë) dhe 61 punonjës (me 4 ditë) pune.
- Në muajn Qershor 2023 ka total 79 punonjës, nga të cilët 18 punonjës i ka me me kohë të plotë (22 ditë), 8 punonjës (me 5 ditë) dhe 53 punonjës (me 3 ditë) pune.
- Në muajn Korrik 2023 ka total 89 punonjës, nga të cilët 18 punonjës i ka me me kohë të plotë (22 ditë), 5 punonjës (me 5 ditë), 1 punonjës (me 4 ditë) dhe 65 punonjës (me 3 ditë) pune.

Sa më sipër rezulton se operatori ekonomik ka mesatarisht 18 punonjës me kohë të plotë nga 30 (tridhjetë) që Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në DST.

Gjithashtu sqarojmë se për punonjësit e specializuar/të kualifikuar që operatori ekonomik ka deklaruar si dhe referuar kontratave individuale të punës që OE ka paraqitur, KVO konstatoi se:

- Punonjësit si: Murator (Denis Aga, Eni Laba).
- Elektricit (Mihal Sadikaj, Kastriot Brati).
- Hidraulik (Ritvan Vela).
- Bojaxhi (Lulo Labaj, Endri Labaj, Shpetim Çela).
- Punëtor të thjeshtë ndërtimi (Ediol Memsullaj, Shkëlqim Sakaj, Mezin Ramohitaj, Oltjon Dollaj, Arbri Laba, Rrapo Merkaj, Memo Shyti, Xhonatan Shyti, Kristjan Begaj, Fadil Lulo, Veiz Bufaj, Renald Kapaj).

Për të gjithë këta punonjës referuar kontratës individuale të punës në nenin 6 pika 2 parashikohet se: *Koha javore normale e punës do të jetë 40 orë në jave.....etj.* ndërsa afati për të cilin lidhet kontrata është 5 (pesë) vjeçar (kontratat janë lidhur në vitin 2022-2027).

Theksojmë se operatori ekonomik referuar kontratave, i ka punësuar punonjësit me kohë të plotë dhe referuar Kodit të Punës, ndërsa referuar listëpagesave (muaj fundit) OE punonjësit e mësipërm i ka deklaruar me nga 3 ditë pune.

Për sa më sipër KVO mendon se ky operator ekonomik nuk ka një staf të specializuar të punësuar me kohë të plotë dhe nuk na bind se e kryen punën me cilësi dhe brenda afateve ligjore. Gjithashtu mendojmë se mos pasja e një stafi me kohë të plotë pune nuk garanton zbatimin e kontrates.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe të nenit 82, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285,

datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik “C O L O M B O” SHPK, **S’Kualifikohet.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**ERAL CONSTRUCTION COMPANY**” SHPK, me adresë: Gjirokaster, Tepelene, Rruga Tepelene Progonat, Vendndodhja Skaranë, ngastra nr.80d, Kod kadastral Gj 3400080d rl, zk 1149, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **7,493,518** (shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Titullari i Autoritetit Kontraktor
Majlinda CARA